



**REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**  
**01 Nr. \_\_\_\_\_ /2022**  
**Dt. 26.05.2022**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. Pika (d), nenit 40 pika (J) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-010 Për Bashkëpunim ndër Komunal, dhe në nenin 6 të Rregullores nr.2023-1334 të datës 18.12.2012, në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.05.2022, pas diskutimeve lidhur më pikën e 3-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për miratimin e Nismës për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar me Bashkinë e Shkodrës, Republika e Shqipërisë, e miratoi këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet NISMA për Bashkëpunimin Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Bashkisë së Shkodrës Republika e Shqipërisë.
2. Bashkëpunimin Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Bashkisë së Shkodrës Republika e Shqipërisë, do të bëhet në fushën e Socio-Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Sportit.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini që ti filloj Konsultimet dhe përgatitjen e Propozim Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndër Komunal .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. **Vendimi iu dërgohet:**
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal .
  - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



**Arbëneshë Kuqi**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



<b>DATË/A/E:</b>	17/05/2022
<b>REFERENCË/E:</b>	01-011/01-12448
<b>PËR/ZA/TO:</b>	znj. Arbënësja Kuqi - Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
<b>CC:</b>	-Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Gjakovës -Arkivit
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM</b>	Ardian Gjini Kryetar i Komunës së Gjakovës
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Propozim Vendim për bashkëpunim komunal ndërkombëtar me qytetin e Shkodrës, Shqipëri



Të nderuar,

Duke u bazuar në, nenin 12 pika (d), nenit 40 pika (j), dhe neni 58 shkronja (h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal, si dhe neni 6 të Rregullores nr. 0203-1334 të dt. 18.12.2012 për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar, Kryetari i Komunës parashtron Kuvendit të Komunës së Gjakovës këtë:

### PROPOZIM VENDIM

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Gjakovës për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal;
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunën e Shkodrës nga Shqipëria;
3. Autorizohet Kryetari i Komunës për të filluar konsultimet me komunën për përgatitjen e propozim marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal;
4. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Gjakovës.

KOMUNA E GJAKOVËS

KABINETI I KRYETARIT

Postal address: Nëna Tereze nr.469 Gjakovë, Kosovë  
kk.rks-gov.net/gjakove/



01 Nr. 413/01-13155  
Dt. 23.05.2022

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndërkomunal, si dhe nenit 5 të Rregullores Për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar 0203-1334 të dt. 18.12.2012, Kryetari i Komunës paraqet kërkesë për miratimin:

**NISMËN  
PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME BASHKINË E  
SHKODRËS**

NË FUSHËN E SOCIAL EKONOMIKE, ARSIMIT, TURIZMIT, TRASHËGIMISË  
KULTURORE DHE SPORTIT

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me bashkinë e **Shkodrës, Shqipëri**;
2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e zhvillimit socio-ekonomik, arsimit, turizmit, kulturës dhe sportit, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushat përkatëse. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik;
3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim - vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës;
4. **Arsyetimi**- Nisma për bashkëpunimin ndërkomunal me Bashkinë e Shkodrës nga shteti i Shqipërisë, bëhet me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes dy Komunave në fushat e lartcekura. Duke u nisur nga bashkëpunimi aktual dhe ngjashmëritë socio-ekonomike dhe kulturore të të dy qyteteve, si dhe në bazë të kërkesës nga ana e shoqërisë civile të të dy vendeve, formalizmi i këtij bashkëpunimi përmes binjakëzimit të qytetit të Gjakovës dhe Shkodrës është shumë i nevojshëm dhe i mirëseardhur.

Kryetari i Komunës së Gjakovës



*Ardian Gjini*  
Ardian Gjini



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 3298 Prot

Shkodër, 23.05.2022

Lënda: Kërkesë për bashkëpunim.

**Z. ARDIAN GJINI**  
**KRYETAR I KOMUNËS GJAKOVË**  
(Adresa: "UÇK" nr. 53, 50000 Gjakovë – Kosovë)

I nderuar Z. Ardian Gjini,

Në vijim të bisedimeve të zhvilluara me përfaqësues të Komunës Gjakovë dhe Bashkisë Shkodër për nxitjen e bashkëpunimit dypalëshe, shprehim angazhimin tonë për të bashkëpunuar në fushën e zhvillimit social ekonomik, turizmit, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe sportit.

Vlerësojmë me shumë kënaqësi interesin e përbashkët për të forcuar bashkëpunimin dypalësh, bazuar në marrëdhëniet e shkëlqyera historike dhe trashëgimisë kulturore. Bashkëpunimi ndërmjet Shkodrës dhe Gjakovës ka qënë shumë dimensional, kjo për shkak të bashkëpunimit të hershëm në fushën e zhvillimit ekonomik dhe tregtar ndërmjet dy qyteteve tona, ngjashmërisë kulturore, arsimit, etj.

Në këtë kontekst, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për të rivendosur marrëdhëniet institucionale me qëllim nxitjen e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, nisur nga mundësitë dhe resurset që Gjakova dhe Shkodra kanë.

Për sa më sipër, bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë një draft të memorandumit të mirëkuptimit, në të cilën pasqyrohen fushat e bashkëpunimit dhe modalitetet përkatëse. Mirëpresim çdo sugjerim tuajin për të qënë pjesë e draftit final të tij.

Me respekt,

KRYETAR

Bardh Spahia

